

TERMAT DHE KUSHTET E KONTRATES: Kontrata realizohet mes H&Dshpk ne cilesine e subjektit qiradhenes dhe personit/personave('ju') ne cilesine e qiramarresit te dhenat e te cilit/cileve jane pasqyruar ne kete forme dhe eshte rene dakort si me poshte :

NENI(1) Pershkrimi I automjetit : Subjekti qiradhenes do te jape me qira dhe qiramarresi do te marre me qira automjetin e pershkruar ne kete kontrate.

NENI(2) |Kohezgjatja e qiramarrjes : Kushtet e qiramarrjes do te jene per periudhat e cilesuara ne kete kontrate. Ne raste te zgjatjes se kontrates sipas dakortesise se dy paleve , pagesa duhet te kryhet ne fillim te zgjatjes se periudhes se qiramarrjes dhe kjo periudhe do te jete pjese e kushteve dhe termave te kesaj kontrate. Qiradhenesit i lind e drejta e posedimit te automjetit te lene me qira ne raste kur shuma e papaguar (perfituar prej qirase) nuk eshte likujduar.Ne kete rast vlera e papaguar dhe cdo kosto qe vjen si pasoje eshte detyrim I qiramarresit .

NENI(3)E drejta e drejtimit te automjetit: Automjeti mund te drejtohet gjate periudhes se qiramarrjes vetem nga qiramarresi te dhenat e te cilit jane pasqyruar ne kontrate dhe kur qiramarresi posedon leje drejtimi te vlefshme ne kategorine perkatese sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI(4)Pagesat e qiramarresit :

a)Qiramarresi duhet likujdoje vleren totale te pageses per qirane e automjetit ne fillim te kontrates.

b)Bashkangjitur nenit 4 qiramarresi duhet te kryeje pagese ne raste si me poshte :

(i)Mungesen e karburantit ne momentin e kthimit te makines.

(ii)Cdo demtim I automjetit qe vjen si pasoje e pakujdesise se qiramarresit percaktuar ne kushtet e perdorimit neni (9) i kesaj kontrate.

(iii) Cdo kosto qe vjen si pasoje e mospageses dhe shkeljes se kushteve te kontrates.

(iv) Pagesat ne rastet e permendura ne nenin 12 te kesaj kontrate.

NENI(5)Detyrimet e qiramarresit :

a)Duhet te sigurohet qe niveli I ujit te jete optimal dhe bateria te jete ne gjendje te mire pune.

b)Duhet te sigurohet qe niveli I vajit te jete optimal

c)Duhet te sigurohet qe gjendja e gomave te jete e mire.

d)Duhet te sigurohet qe I gjithë kujdesi I arsyeshem eshte ndermarre per automjetin ne parkim dhe ne perdorim.

NENI(6) Kthimi I automjetit :

a)Qiramarresi duhet te ktheje automjetin ne kohen e percaktuar prane ambjenteve te kompanise.Ne rast zgjatjeje te kontrates duhet te marre miratimin e agjentit.

b)Qiradhenesi ka te drejten te perfundoje kontraten dhe te marre persiper posedimin e menjehershem te automjetit ne rast shkeljeje te kushteve dhe termave te kontrates,demtimit te makines dhe mospergjigjes se detyrimeve nga ana e qiramarresit.Perfundimi I kontrates me ane te autoritetit te ketij neni duhet te kryhet pa cenuar te drejtat e tjera te qiradhenesit dhe qiramarresit cituar ne kete kontrate.

NENI(7)Detyrimet e qiradhenesit:

(a)Qiradhenesi duhet te sigurohet qe automjeti qe jep me qira te jete ne gjendje te mire teknike dhe te plotesoje kushtet e qarkullimit rrugor.

(b)Qiradhenesi merr persiper kostot e levizjes se makines ku futen : pjese konsumi dhe sherbime periodike.

Qiradhenesi perjashtohet nga cdo kosto tjeter qe jane detyrim I qiramarresit cituar ne nenin 4.

NENI(8)Problemet mekanike te automjetit dhe demtimet

a)Ne raste kur automjeti eshte demtuar ose peson problem , qiramarresi eshte I detyruar te njoftoje qiradhenesin dhe ta informoje mbi cdo rrethane.

b)Zgjidhja e situates mbetet ne autoritetin e qiradhenesit , perjashtuar rastet kur riparimi ose shpetimi I automjetit eshte I domosdoshem ne menyre qe te shmangen demtime ose probleme te metejshme.

c)Qiramarresi duhet te sigurohet qe asnje person I paautorizuar nuk duhet te nderhyje ne asnje pjese te makines ku perfshihen : sistemi I frenave , regjistruesi I distances , te dhenat e kruskotit , motorri , kambio dhe sistemet e ndalimit te mjetit.

d)Cdo demtim I ardhur si pasoje e veprimeve te qiramarresit mbetet detyrim I qiramarresit. Ne kete rast perfshihen : demtimet(vrimat,carjet,plasaritjet) , xhamat dhe feneret.

NENI(9)Perdorimi I automjetit : Qiramarresi nuk duhet te perdore ose te lejoje te perdoret automjetin si me poshte :

a)Automjeti perdoret per transport njerezish ose mallrash.

b)Automjeti perdoret per gara.

c)Automjeti I jepet me qira nje pale tjeter.

d)Automjeti perdoret per qellime te jashtligjshme

e)Automjeti ngarkohet jashte kapacitetit mbajtes dhe perdoret ne rruge jo te pershtatshme per qarkullim.

f)Automjeti drejtohet nga qiramarresi nen efektin e alkolit , droges ose substancave tjera te cilat cenojne aftesite drejtuese te automjetit.

g)Brendesia e automjetit demtohet si pasoje e konsumit,derdhjeve dhe djegieve te lendeve te ndryshme.

h)Automjeti drejtohet nga persona te paautorizuar me ane te kesaj kontrate.

i)Qiramarresi tenton te dale ose del jashte territorit te Shqiperise pa autorizimin e qiradhenesit

j)Qiramarresi neglizhon sinjalet ne automjet dhe nuk njofton qiradhenesin duke shkaktuar probleme ne automjet.

Pasojat ligjore qe burojne nga thyerja e kushteve te kontrates gjate periudhes se qiramarrjes , jane pergjegjesi e qiramarresit,qofshin ato civile ose penale.

NENI(10)Siguracioni : Qiradhenesi sigurohet qe automjeti te jete I pajisur me siguracion TPL dhe kasko ne masen e mbulimit 90%.

Ne rast aksidenti qiramarresi eshte I detyruar te njoftoje policine dhe qiradhenesin , te pershkruaje situaten dhe te plotesoje dokumentacionin e nevojshem.Ne rast aksidenti ,kur qiramarresi deklarohet fajtor(shkaktar) sipas raportit te policise ,qiramarresi eshte I detyruar te paguaje masen administrative, kostot e terheqjes se raportit policor dhe 10% te vleres se demit total te shkaktuar automjetit.Qiradhenesi I zevendeson automjetin per ditet e mbetura te qirase.Ne rast kur qiramarresi perfshihet ne aksident dhe nuk eshte shkaktar sipas raportit policor , qiradhenesi I zevendeson automjetin per ditet e mbetura dhe nuk ka asnje detyrim lidhur me riparimin e automjetit .Ne cdo rast kur qiramarresi perfshihet ne aksident dhe nuk paraqet raport policor ose demton makinen si pasoje e shkeljes se kushteve te perdorimit ne nenin(9) te kesaj kontrate atehere qiramarresi paguan vleren totale te demit te shkaktuar prej tij.Ne cdo rast aksidenti kur automjeti eshte ne gjendje te palevizshme , qiramarresi eshte I detyruar te paguaje sherbimin e karroatrecit per transportin e automjetit ne servis ose prane kompanise.Ne cdo rast aksidenti ose demi qiradhenesi nuk kompenson vleren e diteve te mbetura pervec rastit kur eshte e pamundur per shkak te sezonit te larte dhe nuk ka automjet disponibel.

NENI(11)Anullimi I kontrates

Ne rast se qiramarresi kerkon te prishe kontraten per arsye personale qe nuk kane te bejne me automjetin apo cdo gje qe lidhet me qiradhenesin,nga vlera e kontrates zbritet vlera e diteve te konsumuara dhe 30% e vleres se diteve te paperdorura nga te cilat :

a)20% TVSH.

b)10% penalitet per anullim kontrate.

Diferenca I kthehet qiramarresit.

NENI(12)Pagesa shtese :

(a)Masat administrative ndaj automjetit gjat periudhes se qiramarrjes.

(b)Taksa mbi rruget.

(c)Kostot e pastrimit : Ne rast kur mjeti kerkon pastrim te perkushtuar, do te jete pergjegjesi e qiramarresit.

(d)Sherbimi jashte orarit te punes: Cdo sherbim jashte orarit zyrtar do te paguhet 10€.